



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 74, datë 26.03.2021

**PËR CAKTIM E Z. KRESHNIK AJAZI, NËPËRMJET PROCEDURËS SË  
NGRITJES NË DETYRË, NË POZICIONIN E DREJTUESIT TË  
PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË ELBASAN**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 47 pika 6 dhe 52 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, gërma “a” të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 28 të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm” miratuar me Vendimin nr. 200, datë 23.09.2020 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Të caktojë z. Kreshnik Ajazi në detyrën e Drejtuesit të Prokurorisë, në prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.
2. Z. Keshnik Ajazi të ushtroje funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan nga data 26.03.2021 - 25.03.2024.
3. Të njoftohen për këtë vendim prokurori Kreshnik Ajazi, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan dhe Prokurori i Përgjithshëm.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR  
GENT IBRAHIMI

ZV/KRYETAR  
ALFRED BALLA

ANËTAR  
KOSTAQ BELURI

ANËTAR  
BUJAR SHESHI

ANËTAR  
NURIHAN SEITI

4

ANËTAR  
SANDËR BECI



ANËTAR  
MOISI DUDA



ANËTAR  
VATË STAKA



ANËTAR  
ESMERALDA KESHI



ANËTAR  
TARTAR BAZAJ



ANËTAR  
ELOIDA GOXHI

